

17.09.2021
Ora 12:45

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gjirokastrë,
me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zoti
Shkëlqim Dalip Guçe”**

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra.**

• **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gjirokastrë.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Maksim Eqerem Hoxha, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 25, zoti Shkëlqim Dalip Guçe. Kandidati për anëtar i Këshillit Bashkiak ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2174. Nga verifikimi i këtij formulari rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

bëjë me ndalime të ligjit nr. 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës së KQZ-së, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar verifikimin e të dhënave, ku rezulton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se nuk ka shënime në sistem, pra është i padënuar. Referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17, të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit Bashkiak Gjirokastrë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Mirë atëherë, miratohet vendimi sipas projektaktit!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fletoren zyrtare, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së.

Vendimi nr.444

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



17.09.2021

Ora 12:47

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, zonja Diandra Ferit Kraja.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra**

• **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës për këtë grup çështjesh.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Shkodër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari zonja Jetmira Rexhep Rraboshta, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste për anëtar të Këshillit të Bashkisë Shkodër , të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 11, zonja Diandra Ferit Kraja. Kandidati për anëtar i Këshillit Bashkiak ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklarimit me numër unik 2173. Nga verifikimi i këtij formulari rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikime për ndalim të ligjit nr. 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar verifikimin e të dhënave, ku rezulton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se nuk ka shënime në sistem, pra është i padënuar. Referuar pikës 2 të kreut V, të vendimit nr. 17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit Bashkiak Shkodër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Mirë atëherë, miratohet edhe ky akt sipas projektit!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fletoren zyrtare, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së.

Vendimi nr. 445

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



17.09.2021

Ora 12:48

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shijak, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Adelina Petrit Elezaj”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra**

• **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shijak.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Shijak ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Xhesika Dishir Koka, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumëemërore e kësaj partie për Këshillin e Bashkisë Shijak, është kandidati me numër rendor 18, zonja Adelina Petrit Elezaj, e cila ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2175. Nga verifikimi i këtij formulari rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikime për ndalime, të ligjit nr. 138, të vitit 2015. Edhe për këtë kandidat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

P 

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar verifikimin e të dhënave, ku rezulton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se nuk ka shënime në sistem, pra rezulton i padënuar. Referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Mirë atëherë faleminderit! Miratohet edhe ky akt sipas projektaktit, duke bërë zëvendësimin në Këshillin e Bashkisë Shijak!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fletoren zyrtare, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së.

Vendimi nr.446

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

P 

17.09.2021

Ora 12:49

RENDI I DITËS

“Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dropull, me kandidatën nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Kostandina Grigor Doko”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra

• **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, Bashkia Dropull.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Dropull ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Dhimitraq Apostol Paspali, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Dropull, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 21, zonja Kostandina Grigor Doko, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2173. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikime për ndalime, të ligjit nr. 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile rezulton se nuk ka kthyer

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidaten, zonjën Kostandina Grigor Doko. Rezulton se nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Dropull, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në pozicionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Mirë atëherë, miratohet dhe projektvendimi që ka të bëjë me zëvendësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dropull! Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fletoren zyrtare, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së.

Vendimi nr.447

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

P 

17.09.2021
Ora 12:51

RENDI I DITËS

“Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lushnje, me kandidatën nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zoti Arsid Argjir Prifti”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra.**

• **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lushnje.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Lushnje ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Lindita Izet Buxheli, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste për anëtar të Këshillit të Bashkisë Lushnje, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 39, zoti Arsid Argjir Prifti, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me numër unik 2173, ku nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikime për ndalime në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje,

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të këtij kandidati, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem dhe është i padënuar. Referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në pozicionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit, atëherë miratohet dhe plotësimi i vakancës për Këshillin e Bashkisë Lushnje! Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fletoren zyrtare, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së.

Vendimi nr.448

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



17.09.2021

Ora 12:52

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatën nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Sabrie Rexhë Çelaj”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra**
- **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Tropojë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Agustin Marash Pepkolaj, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste, të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 14, zonja Sabrie Rexhë Çelaj, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2177/1. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se anëtari për Këshillin e Bashkisë Tropojë në rubrikën e të dhënave personale ka ndryshuar gjeneralitetet e mbiemrit nga Gelaj në Çelaj. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje dhe rezulton se nuk ka ndryshime të përbërjes së gjendjes civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit të Këshillit Bashkiak Tropojë, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem dhe rezulton i padënuar. Referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Tropojë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në pozicionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, miratojmë dhe plotësimin e vakancës për Këshillin e Bashkisë Tropojë! Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fletoren zyrtare, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së.

Vendimi nr.449

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



17.09.2021

Ora 12:54

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatën nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Laureta Kastriot Sinanaj”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra

• **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Atëherë, vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancës për Këshillin e Bashkisë Tiranë.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Tiranë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Dajna Edmond Sorensen, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Tiranë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 65, zonja Laureta Kastriot Sinanaj, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2179. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar të dhënat që kanë të bëjnë me ligjin nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje ende, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të këtij kandidati dhe rezulton se është i padënuar dhe nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2 të kreut V të vendimit nr. 17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Tiranë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Miratohet dhe projektvendimi që ka të bëjë me plotësimin e vakancës për Këshillin e Bashkisë Tiranë! Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fletoren zyrtare, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së. Çështje të tjera në rendin e ditës nuk kemi. Atëherë, seanca mbyllet!

Vendimi nr.450

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



17.09.2021
Ora 12:11

RENDI I DITËS

Projektvendim “Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 59, të depozituar nga Organizata “Qëndresa Qytetare” me objekt “Kundërshtim i vendimit nr.423, datë 05.07.2021, ‘Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit ndaj kandidatës për deputete, zonjës Gerta Duraku dhe Zyrës Vendore Arsimore Kukës, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**

- **Parti Politike:** **PS**
- **Organizata “Qëndresa Qytetare”** **R.Xhemollari**

Z.I.Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë në seancën e sotme publike kemi në rendin e ditës 10 pika. Tri pikat e para kanë të bëjnë me shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura nga organizata Qëndresa Qytetare, në lidhje me shkelje administrative të pretenduara nga subjekte zgjedhore dhe funksionarë publikë. Pikat e tjera të rendit të ditës kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në këshillat bashkiakë respektivisht, Gjirokastrë, Shkodër, Shijak, Dropull, Lushnje, Tropojë dhe Tiranë. Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.61, të depozituar nga organizata “Qëndresa Qytetare”, që ka të bëjë me zhvillimin e aktivitetit nga kandidatja për deputete e

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Partisë Socialiste për Qarkun Kukës, zonja Gerta Duraku. Atëherë prezentë përfaqësuesit e organizatës “Qëndresa Qytetare”?

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Përshëndetje!
Rigels Xhemollari, përfaqësues ligjor.

Z.I.Celibashi: Po! Kandidati për deputet nuk është paraqitur?

Z.A.Muslija, drejtor i shkollës, “Shëmri”: Agim Muslija, unë jam drejtori i shkollës “Shëmria”!

Z.I.Celibashi: Dakord, por po pyesja njëherë për kandidatët. Tashmë është deputete zonja. Mirë atëherë, fillojmë shqyrtimin meqenëse qoftë pala e interesuar kërkuese është prezent, por dhe palët e tjera të interesuara në proces, drejtori i shkollës është prezent, atëherë hapim shqyrtimin administrativ. I japim fjalën fillimisht përfaqësuesit të organizatës për të paraqitur pretendimet në lidhje me këtë kërkim, faleminderit!

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: I nderuar komisioner! “Qëndresa Qytetare” është e interesuar që ligji zgjedhor dhe burimet shtetërore të mos përdroreshin në fushat elektorale, dhe ligji të zbatohet siç duhej dhe në partneritet me Ambasadën Britanike në Shqipëri, me Westminster Foundation me Institutin Demokratik Amerikan dhe ndërkombëtarë të tjerë, ne jemi munduar të kontribuojmë për vendin, për të pasur një zbatim të ligjit sa më korrekt. Ne jemi këtu në respekt të institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si të thirrur, dhe i qëndrojmë të gjitha pretendimeve të cilat kemi

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

përcjellë në rrugë shkresore pranë Komisionerit si dhe ato për zgjerimin e hetimit dhe përfshirjen e palëve të treta. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Dakord po në lidhje me faktet apo provat që u japin vërtetësi pretendimeve tuaja në lidhje me shkeljet e pretenduara të ligjit zgjedhor nga subjektet përkatëse.

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Atëherë ne kemi kallëzuar në muajin mars.

Z.I.Celibashi: Flasim për këtë rast fillimisht, për këtë të Kukësit.

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Në muajin mars, rastin e Kukësit, i cili ka të bëjë me një aktivitet elektorale, të zhvilluar në shkollën “Shëmri” të Kukësit, ku ne kemi përcjellë dhe faktuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, provat fotografike të ambjenteve, kemi përcjellë një ekspertizë, e cila fakton edhe vendin se ku është zhvilluar aktiviteti, me baner të Partisë Socialiste, me përfaqësues, kandidaten për deputete zonjën Gerta Duraku dhe me kryetarin e Bashkisë të Kukësit në atë sallë. Pasi ju përfunduat shqyrtimin administrativ të çështjes, pasi ne ju paraqitëm provat, Komisioni i Apelineve dhe Sanksioneve vendosi që të riçelë këtë shqyrtim dhe ne besojmë që ju do të gjykoni bazuar në një hetim më të gjithanshëm dhe më të thelluar mbi këtë çështje.

Z.I.Celibashi: Ju veç atyre provave, të themi, që keni paraqitur, nuk keni prova të tjera të çdo lloj karakteri?

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Të gjitha provat i kemi depozituar pranë KQZ-së.

Z.I.Celibashi: Në rregull, tjetër shtesë veç atyre, nuk keni? Kërkoni nga ana e KQZ-së që të marrë prova të tjera, për të cilat ju mund të jeni në dijeni, por nuk keni patur mundësi për arsye të ndryshme t’i merrni? Nuk keni kërkesa të tilla? Faleminderit! Atëherë i japim fjalën drejtorit të shkollës “Shëmri”, Kukës.

Z.A.Muslija, drejtor i shkollës “Shëmri”: Po, të nderuar drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Unë jam njohur me këtë material që ka ardhur. Në të vërtetë në shkollën “Shëmri” nuk është zhvilluar mbledhje brenda ambienteve të shkollës ,por në ambientet për prezantim të kandidatëve, në ambientet e jashtme të shkollës, po themi, në rrethin e shkollës që është oborri i shkollës dhe jo vetëm për këtë forcë politike, se ne gjithmonë në fshatra s’kanë ku mblidhen, mblidhen aty, shkojnë, afrohen, gjithmonë e kemi bërë këtë dhe nuk e kemi shkelur ligjin në këtë rast, po flas sepse i kam respektuar të gjitha forcat politike, por edhe nga ç’ka unë kam parë, edhe ju i keni të depozituara, edhe kryetari i njësisë vendore ka deklaruar që nuk është bërë brenda ambienteve të shkollës një takim i tillë, edhe zotëria i lokalit nuk e ka pranuar që është e tillë, edhe shokët e tjerë që kanë qenë prezentë, janë të kësaj natyre, s’e kanë pranuar që është zhvilluar brenda ambienteve të shkollës. Megjithatë provat që ka depozituar “Qëndresa Qytetare” për mua nuk qëndrojnë, sepse unë, nuk e di se si mund të lidhen të tilla pamje, nxjerrin pamjen e jashtme të shkollës, kur nxjerrin pamjen e brendshme, ndryshon komplet pjesa e lidhjes. Këta mundohen ta bëjnë me ekspertë, lidhin dritaret e dritaret ai zotëria që i ka dritaret e atilla me vendosje, këta thonë jo pamja e jashtme, brenda ambienteve të lokalit të zotërisë që kanë bërë takimin ata nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

kanë hyrë fare, veç marrin pamje të jashtme. S'e di se nga i lidhin, për mua është montim.

Z.I.Celibashi: Më fal që po ju ndërpres! Pyetja është e thjeshtë. Kërkuesi pretendon që është zhvilluar aktivitet i një kandidati, nuk ka dhe shumë rëndësi sepse njësoj do të ishte për këdo kandidat, aktivitet elektoral në ambjentet e shkollës. Pyetja është, është zhvilluar aktivitet elektoral brenda ambieteve të shkollës, në kuptim, brenda godinës?

Z.A.Muslija, drejtor i shkollës "Shëmri": Jo!

Z.I.Celibashi: Në oborrin e shkollës?

Z.A.Muslija, drejtor i shkollës "Shëmri": Po, në oborrin e shkollës kanë zhvilluar aktivitete!

Z.I.Celibashi: Dakord, faleminderit! Përfaqësuesi i "Qëndresës" ka ndonjë gjë për të shtuar, për të komentuar ose për të sqaruar, nevojë për të sqaruar.

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës "Qëndresa Qytetare": Ne besojmë në gjykimin tuaj të drejtë dhe besojmë që, në qoftë se provat që ne kemi parashtruar nuk ju bindin, atëherë mund të caktoni ekspertë, ose mund të caktoni njerëz të tjerë që mund të gjykojnë mbi këto prova, ndoshta për këtë proces, por ne jemi të bindur në ato që kemi dorëzuar. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, e mbyllim hetimin administrativ në lidhje me këtë çështje. Ne nuk shikojmë nevojën për të marrë prova të tjera në

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021**

lidhje me këtë shqyrtim administrativ. Para se ta shpallim vendimin që nuk do të jetë për ditën e sotme, por do ta lemë një ditë nga java tjetër, përfundimisht përfaqësuesi i “Qëndresës Qytetare”, kërkon që të pranohet kërkesa dhe të vendoset sanksion administrativ,po?

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: U qëndrojmë të gjitha akuzave apo kallëzimeve që kemi ngritur për të gjitha palët e përfshira.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Mirë, e mbylлим hetimin dhe shqyrtimin administrativ për këtë pikë të rendit të ditës dhe shpalljen e vendimit do ta bëjmë ditën e martë, në orën 10:00.

**Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku**



17.09.2021
Ora 12:22

RENDI I DITËS

Projektvendim “Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr.60, të depozituar nga organizata “Qëndresa Qytetare” me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 424, datë 12.07.2021, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Tiranë”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja**

• **Të tjerë:**

1. Organizata “Qëndresa Qytetare” **R. Xhemollari**

2. Kandidatit për deputetë e PS **K. Skëndo**

Z.I.Celibashi: Atëherë kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.60 të depozituar po nga organizata “Qëndresa Qytetare”, që ka të bëjë me zhvillimin e aktivitetit në bibliotekën “Misto Treska”, nga kandidatët për deputetë të Partisë Socialiste. Fjala është për përfaqësuesin e organizatës “Qëndresa Qytetare”.

Z. R. Xhemollari: Faleminderit i nderuar zoti Komisioner! Në vijim të kallëzimeve tona, edhe ky kallëzim është bërë përsëri për shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit të Komisionit Rregullator për përdorimin e burimeve shtetërore.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021**


Bibliotekat e qytetit të Tiranës janë në administrimin e Bashkisë Tiranë dhe janë asete publike të administruara dhe në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe si të tilla ne kemi konstatuar që janë vënë në dispozicion të kandidatëve të Partisë Socialiste për t'u përdorur për fushatë elektorale. Pas vendimit tuaj për të mbyllur procesin hetimor për këtë çështje, ne apelua në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, ky komision vendosi riçeljen e hetimit për këtë çështje dhe ne kërkua të zgjerojmë edhe hetimin, për shkak se zbulua edhe disa prova të reja.

Z.I.Celibashi: Kemi të bëjmë me kërkesën që ka të bëjë me aktivitetin e kandidatëve Skëndo dhe Bllako, për këtë po flasim apo jo?

Z. R. Xhemollari: Përveç provave fotografike, ne evidentuam edhe prova filmike në këtë ambient apo në bibliotekë, të cilat ju kemi vënë në dispozicion me *link*, ku prezent ishte dhe kryetari i Bashkisë Tiranë, zoti Erion Veliaj, i cili është një zyrtar publik dhe është duke konsumuar veprën e veprimtarisë së ndaluar sipas nesh, në këtë çështje, pra duke kundërshtuar vendimin e Komisionit Regullator. Si pasojë kemi kërkua, gjobitjen e subjektit Partia Socialiste, bazuar në nenin 172 të Kodit Zgjedhor. Kemi kërkua gjobitjen e administratorit të bibliotekave të Tiranës, si dhe të zotit Erion Veliaj për pjesëmarrje në veprimtari të ndaluar, publikuar në ATSH, që është agjencia zyrtare e lajmeve shqiptare, pra në një media. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Po, faleminderit! Përfaqësues nga Bashkia e Tiranës, ose nga biblioteka "Misto Treska"? Nuk kemi! Po ju kë përfaqësoni? Mirë, për procedurë, meqenëse ajo kërkesa që po shqyrtojmë tani lidhet me aktivitetin e zhvilluar njëkohësisht, aktiviteti i kandidatit Bllako me kandidaten Skëndo. Atëherë i japim

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021**

fjalën kandidates Skëndo, në lidhje me këtë pretendim të paraqitur nga “Qëndresa Qytetare” dhe vazhdojmë. Faleminderit!

Znj. K. Skëndo: Faleminderit për fjalën! I nderuar kryesues i seancës, jam vënë në dijeni nga institucioni që ju drejtoni në lidhje me ankesën e depozituar të shoqatës “Qëndresa Qytetare”. Referuar këtij njoftimi do bëj me dije dhe arsyen e prezencës time, pranisë time në atë takim, do e bëj të ditur përpara jush, nëpërmjet një parashtrese, të cilën mund ta depozitohet dhe tek ju tani, nëse është e pranueshme?

Z. I. Celibashi: Po, patjetër!

Znj. K. Skëndo: Atëherë, duke ju bërë të ditur juve si drejtues i kësaj seance dhe të pranishmëve që arsyeja e prezencës time në atë takim, pra të datës 18 mars 2021, ishte ftesë e kryetarit të Bashkisë të Tiranës, zotit Erion Veliaj, në lidhje me shpalesjen e ideve, duke qenë se unë kam qenë pjesë e grupit të përgatitjes së materialeve të zgjedhjes së konkursit ku ka marrë pjesë Bashkia e Tiranës për qytetin evropian të rinisë, për vitin 2020, dhe ky takim shpalesi ide të karakterit rinor, social, kulturor, të cilat lidhen me veprimtari që do të zhvillohen përgjatë vitit ku Tirana është zgjedhur si fituese, pra kryeqyteti rinor evropian, do jenë veprimtari, të cilat lidhen me aktivitete rinore dhe ky ishte një takim ku ne kemi biseduar në lidhje me, pak a shumë, interesat që kanë të rinjtë dhe ku do fokusohet veprimtaria. Kjo është arsyeja e pranisë sime në atë takim. Më poshtë, ashtu lidhur tek dokumenti i dorëzuar keni dhe *link*-un ku paraqitet materiali i prezencës së konkursit të qytetit evropian dhe kjo shpjegon dhe arsyen time për të qenë e pranishme. Ju falenderoj për kohën që më kushtuat!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Jeni duke thënë që keni marrë pjesë në këtë aktivitet të zhvilluar tek biblioteka “Misto Treska”, por natyra e aktivitetit nuk ka qenë aspak elektorale, por ka qenë pikërisht për të promovuar rezultatet e konkursit që lidhet me shpalljen e Tiranës “Qytet Evropian të Rinisë” dhe në këtë aktivitet ju mohoni që të jetë zhvilluar fushatë elektorale nga ana juaj apo dikush tjetër, apo dikush tjetër aty për llogari të subjektit që ju ka mbështetur, këtë po thoni?

Znj. K. Skëndo: Po!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Keni diçka tjetër për të shtuar përfaqësuesi i “Qëndresës”?

Z. R. Xhemollari: Për sa i përket zotit Bllako, i cili nuk është i pranishëm sot, unë do të citoj vetëm një fjali të thënë prej tij në këtë takim, marrë nga videoja dhe ju e gjykoni pastaj në qoftë se ka qenë takim elektorale apo jo. “Ndjem i nderuar të jem pjesë e ekipit të Tiranës, si përfaqësuesi i Partisë Socialiste dhe i njësisë nr.1, ku ju të gjithë jetoni dhe do të votoni në 25 prill, ne kemi nevojë për mbështetjen tuaj që gjithë ajo punë e jashtëzakonshme e filluar gjatë këtyre 8 viteve nga Partia Socialiste me në krye kapitenin Edi Ramën, të mos përmbillet në fund të këtij mandati”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Prova të tjera veç atyre çfarë keni paraqitur që në fillim të prezantimit edhe ajo çfarë ju referuat tani, keni?

Z. R. Xhemollari: Jo, përveç provave që kemi depozituar pranë jush, linqeve dhe videove dhe atyre shkresore, nuk kemi të tjera! U qëndrojmë atyre që kemi depozituar!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



17.09.2021
Ora 12:31

RENDI I DITËS

Projektvendim “Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 61, të depozituar nga organizata “Qëndresa Qytetare” me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 427, datë 16.07.2021, ‘Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

- 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli**
- **Parti Politike:** **PS**
 - **Organizata “Qëndresa Qytetare” :** **R.Xhemollari**

Z.I.Celibashi: Atëherë vazhdojmë me pikën tjetër, pikën e tretë në rendin e ditës që ka të bëjë po me kërkesën ankuese të subjektit “Qëndresa Qytetare”, e cila lidhet me zhvillimin e një aktiviteti elektoral nga kandidati për deputet i Partisë Socialiste, Alfred Muharremi në ambientet e bibliotekës “Misto Treska”. Atëherë i japim fjalën përsëri, për të respektuar procedurën, përfaqësuesit të “Qëndresës Qytetare” dhe mandej dhe kandidatit për deputet, zotit Alfred Muharremi, i cili është prezent në këtë dëgjese.

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Përpara se të flisja për këtë çështje, a ka paraqitur zyrtarja e bibliotekës ndonjë justifikim për mospjesëmarrjen? Apo thjesht nuk është paraqitur?

Z.I.Celibashi: Jo, nuk është paraqitur! Ndoshta e ka vlerësuar që nuk ka patur nevojë për të qenë prezent, prandaj do t’i dërgojmë një njoftim nominalisht zotërisë apo zonjës, çfarë është.

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: I nderuar komisioner! Përsa i përket çështjes tjetër jemi pak a shumë në të njëjtat kushte, ku kryetari i Bashkisë Tiranë ka organizuar një takim me votues për herë të parë, ku prezent ka qenë dhe kandidati zoti Muharremi. Ne disponojmë prova filmike, fotografike, si edhe në titujt e videove që ne ju kemi vënë në dispozicion, shkruhet “takim me votuesit për herë të parë”, si edhe gjatë fjalës së tij zoti Muharremi është shprehur në pjesë të videos që “është një gjë e jashtëzakonshme që unë jam pranë të rinjve që votojnë për herë të parë”, pra është e transkriptuar nga videoja që ne kemi depozituar si provë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sigurisht edhe në këtë rast kemi kërkuar vendosjen e masës administrative për Partinë Socialiste, e cila përsërit këtë lloj sjelljeje, sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor, pra shkel për të disatën herë Kodin Zgjedhor. Kërkojmë që përsëri të merret masë administrative ndaj administratores së bibliotekës apo bibliotekave të Tiranës, si edhe ndaj zotit Erion Veliaj, kryetarit të Bashkisë Tiranë, për veprimtari publike të ndaluara. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Z.I.Celibashi: Po, faleminderit! Atëherë i japim fjalën kandidatit për deputet, zotit Alfred Muharremi, në lidhje me pretendimet e paraqitura nga “Qëndresa Qytetare”, për natyrën e aktivitetit të zhvilluar në bibliotekën “Misto Treska”.

Z.A.Muharremi: Dua t’ju informoj, në këtë seancë dëgjimore, së pari se më në fund pas 30 viteve tranzicion, pranë kryetarit të Bashkisë zotit Veliaj, kemi biblioteka pothuajse në shumë lagje. Ky është një prioritet i tij, në mandatin e tij të fundit si kryebashkiak, të ketë bibliotekë në çdo njësi administrative. Bibliotekat janë një hapësirë e veçantë, ku çdo grupmoshë mund të edukojë mendjen, të pasurojë fjalorin dhe mbi të gjitha të ketë edhe një bashkëjetesë vlerash komunitare me të cilën dita-ditës po humbet. Në këtë parantezë, të cilën unë e citova pak më parë, është një prioritet i veçantë, i cili ka një rëndësi të veçantë për mua. Ne organizuam një takim që ishte bashkëbisedim kryesisht me të rinj që ishin dhe votues për herë të parë. Dua t’ju theksoj se ne në këtë ambient nuk kemi pasur asnjë banderolë, asnjë reklamë njoftuese, ku të ishin subjektet zgjedhore të Partisë Socialiste. Nuk kemi patur as sllogane, nuk kemi lobuar as të votohet forca politike në të cilën unë aderoja, por thjesht ka qenë një takim, i cili mua si kandidat më ka sjellë pas në kohë, duke perceptuar peripecitë e jetës sime, lufta drejt bashkësisë së vlerave si vend që ne ishim dhe në sallë, gjë që çdo kush mund të bëhet dikushi në këtë jetë. Unë u prezantova si kandidat në Qarkun e Tiranës, sepse të prezantohesh si kandidat i Qarkut të Tiranës nuk mund t’i shërbesh vetëm një force politike, por i shërben të gjithë vendit, nëse unë do të zgjidhesha. Normalisht, përderisa është një bibliotekë, është një hapësirë ku është pronë edhe e imja i nderuar përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”. Kam të drejtë që edhe unë të flas, të jap ndoshta edhe mendimin tim ndaj një të riu, dy të rinjve, tre të rinjve, të cilët nuk janë me detyrim aty, por janë me dëshirën e tyre. Gjithashtu, dua të të them që kryetari i

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Bashkisë Erion Veliaj është i të gjithëve, sidomos më shumë i kryeqytetasve, sepse është më se e drejtë që prioritetet e tij të diskutohen dhe t'ia paraqesë çdo kandidati të çdo force politike për të ndihmuar në realizimin e tyre. Një nga objektivat e kryetarit, siç ju thashë është që të ketë një bibliotekë në çdo lagje dhe në çdo njësi administrative. Këtë gjë ai mund ta diskutojë normalisht me mua, me çdo përfaqësues kandidat, me çdo deputet që përfaqëson Qarkun e Tiranës, sepse nesër ai do të jetë pjesë e një parlamenti, e një ligjvënësi ku mund të ndihmojë dhe mund të ofrojë një bashkëpunim më të ngushtë të pushtetit qendror me pushtetin vendor. Pra, prezenca e kryetarit të Bashkisë Erion Veliaj, nuk është një prezencë politike, dhe kryesisht për të mbështetur Partinë Socialiste, pavarësisht se ai ka qenë dhe drejtues i qarkut për Partinë Socialiste. Pra, ka qenë një takim që është bërë vetëm e vetëm në kuadër të një bashkëbisedimi midis disa të rinjve, të cilët janë votues për herë të parë, të disa të rinjve të cilët kanë dëshirë që të kenë një bashkëjetesë shumë të mirë sociale midis njerëzve dhe komuniteteve të ndryshme sociale. Pra të nderuar, biblioteka “Misto Treska” nuk është shndërruar në zyrë elektorale, apo përdorimi i saj nga forca politike, por ka përcjellë thjesht mesazhe, të cilat i mungojnë sot vendit tonë. Ju faleminderit, kjo ishte replika ime.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Ju jeni duke thënë që aktiviteti është zhvilluar në bibliotekë, por nuk ka qenë aktivitet elektorale dhe ju nuk keni zhvilluar aspak fushatë elektorale si kandidat i një subjekti zgjedhor, në këtë aktivitet?

Z.A.Muharremi: Jo absolutisht, unë jam prezantuar si kandidat, por ideja dhe të gjithë mesazhet, të cilët janë përcjellë apo gjithë bashkëbisedimi, ka qenë një bashkëbisedim kryesisht se si unë isha para shumë vitesh votues për herë të parë që nuk kisha një bibliotekë ku mund të studioja dhe sesi sot kryeqyteti i Tiranës është

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

shndërruar në një hapësirë të veçantë biblioteke, ku për mua ka një rëndësi të veçantë libri dhe për këtë gjë ne ishim atje.

Z.I.Celibashi: Po, faleminderit! Përfaqësuesi i “Qëndresës Qytetare”, diçka shkurtimisht.

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Diçka shkurtimisht domethënë. Ne nuk vëmë në diskutim se sa të mira janë bibliotekat apo jo dhe për ne mund të ketë edhe një bibliotekë për çdo pallat, ose mund të shihet edhe biblioteka qendrore që nuk aksesohet nga të rinjtë sot. Ne duam të shohim që është shkelur ligji zgjedhor apo jo? Ka qenë kandidati, kanë qenë votuesit për herë të parë? Është prezantuar si kandidat në një aset publik. Ne për këtë kemi ardhur këtu dhe kemi prova.

Z.A.Muharremi: Aset publik që është i imi, nuk më takon mua që të jem aty, që të prezantohem? Një pyetje kam kështu drejtpërdrejt.

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Gjykimi i takon Komisionerit.

Z.A.Muharremi: Dakord, në rregull.

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Ne kemi parashtruar provat, u qëndrojmë atyre.

Z.A.Muharremi: Është e lirë, janë biblioteka të lira....

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Ligji dhe Kodi Zgjedhor është shumë i qartë, neni 91, vendimi i Komisionit Rregullator dhe besoj se do të ketë një gjykim të drejtë mbi këtë çështje.

Z.I.Celibashi: Një pyetje kam. Nga provat që keni depozituar në KQZ dhe ju vetë i keni dhënë një vlerësim atyre provave. Për ju prania e kandidatit për deputet të subjektit zgjedhor Partia Socialiste, vetëm si prani e tij në këto ambiente, konsiderohet sipas jush aktivitet politik, apo këtë gjykim, këtë vlerësim e jepni bazuar në përmbajtjen e atij aktiviteti, në kuptimin e çfarë është komunikuar ndërmjet subjektit që ju i keni kallëzuar edhe pjesëmarrësve të tjerë. Keni një vlerësim në lidhje me natyrën e tij si aktivitet apo thjesht fakti i vetëm që kandidati për deputet, qoftë edhe në cilësinë e tij si kandidat për deputet, ka qenë atje dhe pavarësisht se natyra e bashkëbisedimit dhe komunikimit atje mund të ketë qenë ose jo me karakter politik ose elektoral.

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Vetë prania e kandidatit për deputet në një aset publik, ku dhe vetë kandidati e pranoi se unë jam prezantuar para të rinjve që votojnë për herë të parë, si kandidat për deputet dhe fjala e tij që thotë, në tekstin që unë parashtrova “Është gjë e jashtëzakonshme që unë sot jam pranë të rinjve që votojnë për herë të parë...” dhe prania e kryetarit të Bashkisë brenda këtij asemi publik, që i ka vënë në dispozicion këtë aset publik kandidatit, ndoshta partitë e tjera nuk e kanë patur këtë mundësi, besoj që krijon edhe disfavorin dhe shkeljen e pretenduar, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Z.I.Celibashi: Kuptoj, pra të paktën për ju kaq është e gjithë përmbajtja në substancën e komunikimit dhe bashkëbisedimit që ka zhvilluar kandidati për deputet atje. Keni një të dhënë, indicie ose provë në lidhje me ftesa nga ana e kandidatit për të votuar atë si kandidat për deputet, për të votuar subjektin zgjedhor politik që ai ka përfaqësuar?

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Vetëm në rastin e zotit Bllako kishim thirrje të drejtpërdrejtë, siç jua citova, kurse në rastin e zotit Muharremi kishim elementet që parashtrova, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Po, fjala për ju zoti Muharremi.

Z.A.Muharremi: Ishte një përgjigje shumë korrekte. Nga ana ime nuk është cituar që as unë të votohem si kandidat, as forca ime politike të votohet si forcë për zgjedhjet e 25 prillit, por ka qenë thjesht e vetëm karakteriale, ka qenë humane, sociale, si ta gjykoni, si ta mendoni. Keni një video rreth 15 minuta dhe fjala e kryetarit është për një bashkëveprim që unë nesër do të isha në qeveri, pra do të zgjidhesha si deputet i Republikës së Shqipërisë, të kishim një bashkëpunim edhe më të ngushtë midis pushtetit qendror dhe pushtetit lokal. Sapo dëgjova që ju këtu po diskutoni dhe për diskriminim që mund t’i jetë bërë një kandidati tjetër, por ftesa ka qenë e lirë gjatë gjithë kohës. Ftesa e kryetarit të Bashkisë që ai të bashkëpunojë më këdo dhe cilindo në interes të publikut dhe në interes të qytetarëve të tij, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Këtë të fundit nuk e dimë, por gjithsesi po e marrim si të mirëqenë nga ana juaj. Përpara se ta përfundoj hetimin administrativ, prova të

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

tjera nga përfaqësuesi i “Qëndresës Qytetare”, veç atyre që janë depozituar deri më sot në KQZ?

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Vetëm ato që kemi depozituar në rrugë shkresore pranë KQZ-së.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Atëherë nga ana e kandidatit për deputet?

Z.A.Muharremi: I gjithë regjistrimi i kësaj është, mund të përbëjë provë materiale për ju.

Z.I.Celibashi: Të tjera nuk kërkoni?

Z.A.Muharremi: Jo!

Z.I.Celibashi: Mirë faleminderit! Mirë atëherë përfundojmë hetimin administrativ. Gjykoj që nuk ka vend për të kërkuar për marrjen e provave të tjera në lidhje me këtë çështje. Para se të shpallim vendimin, përfundimisht përfaqësuesi i “Qëndresës Qytetare” në lidhje me këtë kërkim, vazhdoni t’i qëndroni objektit?

Z.R.Xhemollari, përfaqësues i organizatës “Qëndresa Qytetare”: Vazhdojmë t’i qëndrojmë objektit, kërkojmë marrjen e masave administrative për administratoren e bibliotekave të qytetit të Tiranës, marrjen e masës për Partinë Socialiste si subjekt zgjedhor për shkeljen e nenit 172 dhe marrjen e masës për kryetarin e Bashkisë Tiranë, për pjesëmarrje në veprimtari të ndaluar, bazuar në vendimin e Komisionit Rregullator, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.17.09.2021*

Z.I.Celibashi: Po, faleminderit! Mirë, edhe për këtë shqyrtim administrativ, vendimin do ta shpallim ditën e marte, ora 10:00. Faleminderit, seanca mbyllet.

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*

